



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrat

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Kushtet dhe mundësitë e përkrahjes së edukimit parashkollor nga komuniteti

NUMËR: 42 /2007

DATË: 9.10. 2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25 paragrafi 7 i Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, nenit 7.3 të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më poshtë MASHT), nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

Neni 1

Qëllimi

Ky UA ka për qëllim që komuniteti në bashkëpunim me komunën të siguroj kushte për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore dhe mirëvajtjen e punëve në këto institucione.

Neni 2

1. Komuniteti në bashkëpunim me komunën është i obliguar që të siguroj objektin ku do të mbahet edukimi parashkollor në bazë të standardeve të aplikuara.

2. Komuniteti në bashkëpunim me komunën është i obliguar të siguroj edukatorët dhe personelin tjetër të nevojshëm përmes konkursit publik duke bërë edhe financimin e tyre.
3. Komuniteti në bashkëpunim me komunën është përgjegjës për mirëmbajtjen e objektit, higjienës, rrethojës, kopshtit dhe lodrave për rekreacion.
4. Komuniteti në bashkëpunim me komunën është përgjegjëse për sigurimin e ushqimit dhe fjetjes në ato raste kur fëmijët qëndrojnë gjatë tërë ditës.

Neni 3

1. Komuniteti zgjedh Këshillin prej 7 (shtatë) anëtarësh.
2. Këshilli i komunitetit zgjedh kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin nga radhët e veta, të cilët janë përgjegjës për kontaktet me komunën, nënshkrimin e marrëveshjeve në emër të komunitetit.

Neni 4

Detyra e komunitetit është që të evidentojë fëmijët të cilët dëshirojnë të shkojnë në institucionin parashkollor, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, e për këtë ta njoftojnë Drejtorinë Komunale të Arsimit.

Neni 5

Këshilli i komunitetit mbledh opinionet e komunitetit përmes takimeve dhe zhvillon takime me komunën për zgjerimin e kapaciteteve.

Neni 6

1. Komuniteti mund të krijojë fonde për këtë qëllim.
2. Fondet mund të sigurohen nga buxheti i komunës, donacionet, dhuratat nga participimi i prindërve apo nga kontributi i qytetarëve të mjedisit përkatës.
3. Krijimi i fondeve nga kontributi i qytetarëve rregullohet me rregullore të cilën e harton Këshilli i komunitetit dhe aprovohet nga shumica e qytetarëve të cilët janë të lidhur drejtpërdrejt me interesin e fëmijëve të tyre.

Neni 7

1. Komuniteti deponimin e mjeteve e bën në një nga bankat e afirmuara në mjedisin e vet, duke përcaktuar qëllimin e deponimit.
2. Tërheqja e mjeteve nga banka bëhet vetëm në bazë të faturave të cilat dëshmojnë shpenzimet e bëra për qëllimin e destinuar.

Neni 8

Komuna siguron vendin e ndërtimit të institucionit parashkollor, sipas projektit duke siguruar infrastrukturën e nevojshme.

Neni 9

Komuniteti mund të ndihmojë me mjete financiare për inventar, lodra, mjete të konkretizimit, lojëra sportive dhe aktivitete të tjera rekreative jashtë institucionit parashkollor. Por, për këtë paraprakisht është e domosdoshme që Këshilli i komunitetit të ketë një shkresë zyrtare nga drejtuesi i institucionit me specifikimin e nevojave dhe paralogaritë financiare.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me nënshkrimin e ministrit.

Agim Veliu, ministër